



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE**

**III. Sekretari Shkencor
(Kriteret e dhe procedurat)**

Mbështetur: **1.** Ligjit nr. 9655 datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave të Rrepublicës së Shqipërisë*, neni 11, *Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë* (ndryshuar me Ligjin nr. 9853, datë 26.12.2007, neni 7); **2.** *Statutit organik të saj*, neni 17 dhe neni 18; **3.** *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*;

Me përfundimin e mandatit të Sekretarit Shkencor më 28 maj 2019;

Përmes kësaj thirrjeje publike ftohen për konkurrim: **1.** Anëtarët e Asamblesë me titullin *akademik, akademik i përhershëm ose akademik i asociuar*;

I. Kërkesa për dokumentacion:

Sipas procedurës së parashikuar në Statut, kandidatët duhet të paraqesin pranë Akademisë së Shkencave:

- 1.** Kërkesë vetjake për aplikim drejtuar Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
- 2.** Fotokopje të kartës së identitetit / pasaportës;
- 3.** Curriculum Vitae;
- 4.** Listë të studimeve të botuara (monografi, artikuj);
- 5.** Platformë për mënyrën e ushtrimit të funksioneve të tij për mbarëvajtjen e Akademisë së Shkencave gjatë mandatit të tij;
- 6.** Formular aplikimi për informim për zyrtarët para emërimit / zgjedhjes në poste të larta (sipas nenit 29, pika 1, germa gj, të Ligjit nr. 45/2015 *Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*);
- 7.** Formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit konfirmohet mosekzistenca e shkaqeve penguese për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar, sipas Ligjit nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që*

zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Formulari gjendet në webin e Akademisë së Shkencave, në linkun e mëposhtëm:

<http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

II. Kalendar i procesit zgjedhor:

1. Pranimi i dokumentacionit për konkurrim është nga data 10 prill 2019 deri më 10 maj 2019.
2. Procesi i verifikimit në rrugë institucionale të garancive ligjore sipas pikave 6 dhe 7, nga data 10 deri më 15 maj 2018;
3. Mbledhja e Asamblesë për votimin e kandidatave do të zhvillohet më 24 maj 2019, ora 10.00, në sallën *Aleks Buda*.
4. Para votimit kandidatët do të paraqesin projektin e tyre për drejtimin e institucionit. Koha në dispozicion të çdo kandidati është 15 minuta. Anëtarët e Asamblesë kanë të drejtë të bëjnë pyetje rreth projekteve.

III. Procedura e konkurrimit dhe e votimit:

1. Kandidatë për funksionin e Sekretarit Shkencor të Akademisë së Shkencave mund të jenë *anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm ose anëtarët e asociuar* të Asamblesë.
2. Zgjedhja e Sekretarit Shkencor bëhet me votim të fshehtë, në mbledhjen e përgjithshme të Asamblesë, pa debat.
3. Shpallet i zgjedhur në funksionin e Sekretarit Shkencor kandidati që fiton shumicën absolute (50 për qind +1) të votave të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
5. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet dhe fitues shpallet kandidati me 50 për qind + 1 të anëtarëve Asamblesë të pranishëm në votim.
6. Mandati në detyrë është 4-vjeçar dhe fillon ditën e zgjedhjes nga Asambleja. Mandati i Sekretarit Shkencor nuk përsëritet dy herë rresht.

IV. Detyrat e Sekretarit Shkencor të Akademisë, sipas rregullores së brendshme të Akademisë së Shkencave, kreu III, *Funksionet drejtuese*, neni 9, janë:

Sekretari Shkencor është anëtar i Kryesisë së Akademisë së Shkencave, i zgjedhur nga Asambleja e saj. Ai ka këto detyra:

- Ndjek zbatimin e vendimeve të Asamblesë e të Kryesisë; përgatit mbledhjet e tyre;
- Kujdeset për paraqitjen e programit shkencor të Akademisë dhe raporton për veprimtarinë e përgjithshme të saj në bazë të programeve dhe raporteve të paraqitura nga seksionet dhe njësitë e tjera;
- Zëvendëson dhe përfaqëson Kryetarin sipas urdhrit të tij, për çështje të veçanta ose për mbarë veprimtarinë e Akademisë për një periudhë kohe të caktuar;
- Mbulon veprimtarinë e aparatit administrativ të Akademisë: sektorin e financës, sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, marrëdhëniet me jashtë dhe me publikun, sektorin e botimeve shkencore dhe bibliotekën shkencore, njësinë e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik dhe të inovacioneve;
- Për kontrollin e realizimit të detyrave nga sektorët përkatës, Sekretari Shkencor kërkon periodikisht nga drejtuesit e tyre raport me shkrim. Për analizën e veprimtarisë së sektorëve dhe të raporteve të paraqitura prej tyre, organizon mbledhjen e drejtuesve të tyre kur e vlerëson ai të nevojshme;
- Në rastin e organizimit të mbledhjeve me tematikë apo problematikë të caktuar, një ditë përpara zhvillimit të saj, u njofton përgjegjësve të sektorëve përkatës rendin e mbledhjes, orën dhe vendin e zhvillimit të saj;
- Në mënyrë periodike raporton tek Kryesia për punën dhe veprimtarinë e administratës të Akademisë së Shkencave;
- Merr masa për administrimin e frytshëm të burimeve njerëzore, të mjeteve financiare e burimeve materiale të ASH, me miratimin e Kryesisë;
- Përgatit analiza, raporte dhe bën propozime për mbarëvajtjen e punës së strukturave në varësi të tij;
- Propozon strategji që kanë të bëjnë me drejtimin, motivimin dhe menaxhimin e personelit të strukturave të tjera të varësisë;
- Ndërmerr nisma me administratën në lidhje me praninë e disiplinën në punë;
- Si epror i drejtpërdrejtë, bën vlerësimin e punës për nëpunësit civil në varësi të tij;
- Kryen veprimtari kërkimore shkencore vetjake.